




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 18 maj 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3239_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Dispozitat e Nenit 28, Paragrafi 1.27 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085); Dispozitat e Nenit 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, dhe Kërkesën e OSSH-së, të datës 15.07.2025 për shqyrtim dhe aprovim të Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes 2026 – 2030,

në seancën e mbajtur me datë 18 maj 2026 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** - Plani Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2026 – 2030 për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes.
- II. **OBLIGOHET** – Operatori i Sistemit të Shpërndarjes KEDS SH.A, që të zbatojë projektet e planifikuara sipas këtij plani për funksionimin më të sigurt të Sistemit të Shpërndarjes.

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) me datë 15.07.2025 ka pranuar kërkesën e OSSH-së për shqyrtim dhe aprovim të Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2026 – 2030.
- ZRRE pas shqyrtimit fillestar të Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2026 – 2030, ka konstatuar se i njëjti është harmonizuar me Planin dhjetë (10) vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes, si dhe ka dhënë komentet fillestare dhe ka kërkuar që dokumenti të harmonizohet me palëve KEDS dhe KOSTT.
- ZRRE pas vlerësimit të Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes, të njëjtin e ka hapur për diskutim publik për të pranuar komente, sugjerime dhe vlerësime si nga të licencuarit po ashtu edhe nga palët e interesit.



- Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas takimeve të shumta mes ZRRE, KOSTT dhe KEDS rreth harmonizimit të planeve, OSSh pas përfshirjes së komenteve ka dërguar për miratim në ZRRE Planin Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes 2026 – 2030 të reviduar dhe harmonizuar me KOSTT.
- Pas arritjes së marrëveshjes me Elektroserver për furnizimin e katër komunave në veriun e Kosovës është paraqitur nevoja për investime shtesë nga OSSH-ja, të cilat nuk kanë mundur të shqyrtohen dhe vlerësohen në planin e aprovuar të investimeve për periudhën e tretë rregullative (2023-2027), sepse implementimi i kësaj marrëveshje ka filluar nga 1 janari 2024. OSSH është ende në fazën e mbledhjes së të dhënave nga terreni mbi gjendjen ekzistuese, në bazë të cilës do të hartohet plani i detajuar për investimet e domosdoshme në katër komunat e veriut të Kosovës. Investimet e parapara në katër komunat në veri kanë të bëjnë me instalimin e njehsorëve, investime në stabilimente elektroenergjetike të tensionit të mesëm dhe të ulët si dhe janë paraparë investimet urgjente në infrastrukturë.
- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të Planit Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2026 – 2030, ka konstatuar që janë përmbushur kërkesat ligjore, dhe ka vlerësuar se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme, teknikisht të justifikuara dhe të nevojshme për zhvillimin dhe funksionimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.





Shtojcë: **Plani Pesë (5) Vjeçar për Zhvillimin e Rrjetit të Shpërndarjes për periudhën 2026 – 2030.**


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtar


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtar


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KEDS SH.A., dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji